

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "TELE SPORT" SHA

Sot më Datë 02.09.2021, Ditë e Enjte, Ora 10:00, pranë Selisë së Shoqërisë "Tele Sport" Sha, mbahet Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë.

Mbledhja celet dhe kryesohet nga Administratori i Shoqërisë Z.Zaheer Sultan Storey, I cili merr fjalën:

Administratori: -Të Nderuar Aksionar përshëndetje. Përpara shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, të verifikojmë fillimisht nëse kemi kuorumin e nevojshëm për vendimarrje në Asamble. Janë të pranishëm të mbledhje Aksionarët e mëposhtëm:

Enklajd Malo, zotërues i 20% të Aksioneve të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë.

Hauard Malo, zotërues i 20% të Aksioneve të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë.

Migena Malo, zotëruese e 20% të Aksioneve të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë.

Miranda Malo, zotëruese e 20% të Aksioneve të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë.

Është e përfaqësuar rregullisht në mbledhje, në përputhje me Nenin 232 të Kodit të Familjes Aksionaria Perla Malo, zotëruese e 20% të Aksioneve të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, e mitur dhe pa zotësi juridike për të vepruar, përfaqësuar nga e Ëma Znj.Miranda Malo, në cilësinë e Përfaqësueses Ligjore të të Miturës.

Nga sa më sipër, rezulton se në këtë Mbledhje Asambleje kemi prezencën e Aksionarëve që përfaqësojnë 100% të aksioneve të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë.

Nëse nuk ka kundërshtime apo pretendime paraprake, sugjerojmë me diskutimin në lidhje me çështjet e rendit të ditës.

Ortakët: - Të vijojmë me diskutimin e çështjeve të rendit të ditës.

Administratori: -Ashtu sic ju është bërë me dije në dokumentin e njoftimit të mbledhjes, rendi I ditës së kësaj mbledhje është diskutimi dhe vendimarrja mbi shndërrimin e formës ligjore të organizimit të Shoqërisë "Tele Sport" nga Shoqëri Aksionare në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Në rast se votohet pro shndërrimit të mësipërm të propozuar, atëherë në këtë mbledhje do të thirremi për të votuar edhe për miratimin e Statutit të Ri të Shoqërisë, të organizuar në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

...

Propozimi i shdërrimit të formës ligjore të organizimit të Shoqërisë në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar erdhi nisur nga aktiviteti i ngushtë ekonomik I ushtruar aktualisht nga Shoqëria, I cili është fokusuar vetëm në operimin e një faqeje informatike me karakter sportiv, në aplikacionin Facebook.

Në këto kushte, Unë Administratori, vlerësoj se forma ligjore e organizimit si Shoqëri aksionare, është tepër komplekse për kushtet aktuale të Shoqërisë, duke vlerësuar si më të përshtatshme një formë organizimi më të thjeshtë, e cila njëkohësisht ul kostot e aktivitetit dhe bën më të shpejt dhe efikase kontrollin dhe vendimarrjen mbi çështjet e aktivitetit të Shoqërisë.

Bazuar në sa më lart, ju ftoj të votoni mbi cështjen e parë të rendit të ditës, atë të shndërrimit të formës ligjore të organizimit të Shoqërisë "Tele Sport", në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Aksionari Enklajd Malo-Votoj pro shndërrimit të formës ligjore të organizimit të Shoqërisë në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Aksionari Hauard Malo-Votoj pro

Aksionari Migena Malo-Votoj pro

Aksionaria Miranda Malo-Votoj pro

Aksionaria Perla Malo, përfaqësuar nga Znj.Miranda Malo-Votoj pro.

Administratori-Bazuar në votat tuaja, shndërrimi i Shoqërisë "Tele Sport" nga Shoqëri Aksionare në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, u votua pro nga 100% e Aksionarëve të Shoqërisë. Në këto kushte, duke qënë se nga ana juaj u pranua unanimisht shndërrimi i shoqërisë në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, propozoj të kalojmë në miratimin e Draftit të Statutit të Ri të Shoqërisë, i cili është përshtatur sipas rregullimeve ligjore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Aksionari Enklajd Malo-Jam dakort me Draftin e Statutit të Ri.

Aksionari Hauard Malo-Votoj pro.

Aksionari Migena Malo-Votoj pro

Aksionaria Miranda Malo-Votoj pro

Aksionaria Perla Malo, përfaqësuar nga Znj.Miranda Malo-Votoj pro.

Administratori-Bazuar në votat tuaja, Statuti i Ri i Shoqërisë "Tele Sport" Shpk shpallet i miratuar.

Mbi bazën e vendimeve të marra prej jush me unanimitet në këtë mbledhje asambleje, nga ana ime do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore të parashikuara nga Neni 228 e vijues i Ligjit Nr.9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar. Në përfundim të tyre, I gjithë dokumentacioni i nevojshëm do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim për tu reflektuar ndryshimet në ekstraktin e Shoqërisë.

Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj.

Aksionarët-Faleminderit,

Mbledhja e Asamblesë u mbyll në Orën 13:30.

Kryetari i Mbledhjes

Zaheer Sultan Storey



Mbajtëse e Procesverbalit

Paola Dhami

